

Znj. Magda Mierzewska

Znj. Magda Mierzewska ka diplomuar në Universitetin e Gdanskut, në Poloni, dhe ka arritur shkallën magjistrat të drejtësisë (LLM) në vitin 1980 dhe ka kaluar me sukses Provimin Shtetëror të Polonisë për postet gjyqësore në vitin 1982. Ajo u pranua në Odën e Këshilltarëve Juridik të Gdanskut në vitin 1989, ndërsa e ka fituar titullin LLM në të Drejtën e Bashkimit Evropian në Universitetin Leicester në vitin 2005.

Znj. Mierzewska ka punuar si mësimdhënëse në Fakultetin Juridik, Departamenti i të Drejtës Ndërkombëtare, në Universitetin në Gdanskut nga viti 1982 deri në vitin 1991. Ajo u emërua Avokate në Sekretariatit e Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në Strasburg në vitin 1993. Pastaj, nga viti 1998 ajo ishte punësuar juriste në Sekretarinë e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg, Francë.

Ajo ka një përvojë të gjatë në trajnimet ndërkombëtare për çështje të ndryshme thelbësore dhe procedurale për të drejtat e njeriut, kryesisht për avokatë, gjykatës, prokurorë dhe organizata jo-qeveritare.

Publikimet e shumta akademike të znj. Mierzewska përfshijnë: Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut: Dhjetë vite pas Ratifikimit, Zyra për Informim e Këshillit të Evropës në Varshavë, 2004; Pas dhjetë viteve: Popullariteti i Konventës në Poloni (bashkë-autor), Shqyrtimi i Ligjeve Evropiane për të Drejtat e Njeriut, botimi i 4, 2004; Pas dhjetë viteve: Praktika gjyqësore polake voluminoze dhe interesante (bashkë-autor), Shqyrtimi i Ligjeve Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Botimi 5, 2004; Standardet e përcaktuara në praktikën gjyqësore të KEDNj në Rastet lidhur me shpronësimet dhe aplikimin e tyre për kërkesat pronësore Gjermane, Instituti Polak për Marrëdhënie të Jashtme, 2005; Procesi i pranimi të Konventës Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut në Poloni dhe Sllovaki në: Pranimi i Konventës Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, eds. H. Keller, A. Stone-Sweet, Oxford University Press, maj 2008.

Znj. Mierzewska është emëruar anëtare e Panelit për Shqyrtimin e Drejtave të Njeriut të EULEX-it nga ushtruesi i detyrës së shefit të misionit EULEX më 4 maj 2010.